



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

Për:	Ertan Munoglu – Menaxher i Programit
Nga:	Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume
Kopje:	Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv
Data :	12 prill 2011
Subjekti :	Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Arsimit dhe Kulturë

HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë me datën 12 prill mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të dytën me rend për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z.Azem Guri – Kryesues, z.Qerim Selimi – Zv.kryesues, dhe anëtarët z.Jashar Lushtaku, znj. Fahrije Kryeziu, znj. Verica Ristić dhe z.Nexhmi Rudari. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK, dhe Shemsedin Mujko – Përkthyes .

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

PËRMBLEDHJE:

Mbledhjen e hapi z. Azem Guri me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunitat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës të kolegjiut për arsim dhe kulturë në vitin 2011.

- **Sigurimi i cilësisë në arsim** duke pasur për objektivë ngritjen e kapaciteteve menaxhuese në shkollë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve për mësimdhënie.
- **Infrastruktura shkollore** duke pasur për objektivë përmirësimin e kushteve të punës në shkollë, unifikimin e rregulloreve komunale për arsim si dhe rrjetëzimin e shkollave.

Takimi kishte për objektiv edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë.

Takimi i radhës

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë të mbahet të mërkurën me datën 27.04.2011 në Restorant Adriatiku në Batllavë duke filluar nga ora 11:00.

Agjenda e takimi është përcaktuar si vijon:

1. Plani i punës së Kolegjiut për vitin 2011
2. Përgatitjet për provim shtetëror të maturës për klasët V dhe IX
3. Shqyrtimi i disa Udhëzimeve Administrative
4. Plani për implementimin e formulës së financimit në nivel shkolle

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.